TABELE ME MATERIALE TE BUTA QE DO BLIHEN PER RINOVIMIN E INVENTARIT EKZISTUES

Nr.	Artikulli	Njesia	Sasia e inventarit qe duhet per funksionimin e	Sasia e inventarit gjendje	Sasia qe duhet te blihet vitin e pare 2021-2022	Sasia qe do blihet vitin e dyte 2022-2023	Sasia qe do blihet vitin e trete 2023-2024	Sasia qe do blihet vitin e katert 2024-2025	Jetegjatesia
1	Dyshek	cop	117	117	35	35	47	0	5 vjet
2	Dyshek neonati	cop	12	12	-	-	12	-	5 vjet
3	Jastek	cop	129	30	29	50	50	-	1 ne 2 vjet
4	Carçaf shtrati	cop	351	200	-	351	351	351	1/vit
5	Carçaf zarf	cop	117	100	-	117	117	117	1/vit
6	Kellef jasteku	cop	172	80	-	172	172	172	1/vit

Dokumentat standarde të tenderit

7	Batanije per te rritur	cop	115	0	60	55	60	55	2 ne 4 vjet
8	Batanije neonati	cop	24	40	0	0	8	0	2 ne 4 vjet
9	Jorgan me Vatine	cop	117	30	40	47	30	0	1 ne 4 vjet
10	Kellef dysheku	cop	117	60	57	117	117	117	1/vit
11	Kellef dysheku neonati	cop	12	0	12	12	12	12	1 /vit
12	Pizhama pacienti	cop	30	15	18	33	33	33	1/ vit
13	Kemisha grash	cop	20	0	20	20	20	20	1/ vit
14	Robdishan	cop	15	0	15	15	15	15	1/ vit
15	Pandofla pacienti	cop	44	0	58	58	58	58	1 /vit
16	Peshqire pacienti	cop	44	100	88	88	88	88	1/ vit
17	Kompresa	cop	120	60	60	60	60	60	4 muaj
18	Perparse kirurgu	cop	15	15	15	15	15	15	1 vit
19	Kostume per ekipin e salles	Palë	20	25	25	25	25	25	1 vit
20	Peshqire salle	cope	24	0	24	24	24	24	1 vit
21	Përparëse mjeku	cop	58	83	58	58	58	58	1 vit
22	Kostume infermieri	cop	174	180	174	174	174	174	1 vit
23	Kostume sanitare	cope	40	40	40	40	40	40	1 vit
24	Peshqire personeli	cope	136	136	136	136	136	136	1 vit
25	Pandofla personeli	pale	136	136	136	136	136	136	1 vit

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Më poshtë janë specifikimet e materialit të butë që do të lahet, blihet dhe zëvendësohet sipas jetëgjatësisë së materiali përkatës dhe kushteve të autoritetit kontraktor.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALIT TË BUTË PËR PACIENTIN				
Emërtimi	Njësia	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji i materialit
Dyshek tek spitalor	Copë	Dysheku të jetë i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbërja nga brënda me dy shtresa vatine të fortë, ku nga njëra anë të ketë porozitet për qarkullimin e ajrit, dhe i veshur nga jashtë me mbulesë të fortë të padepërtueshme, injifugo (kundër zjarrit), antibakteriale dhe antialergjike. Të ketë të shënuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Ngjyra sipas kërkeses se autoritetit kontraktor.	190x90x10 cm	

Dokumentat standarde të tenderit

Dyshek pediatrik	Cope	Dysheku të jetë i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbërja nga brënda me dy shtresa vatine të fortë, ku nga njëra anë të ketë porozitet për qarkullimin e ajrit, dhe i veshur nga jashtë me mbulesë të fortë të padepërtueshme, injifugo (kundër zjarrit), antibakteriale dhe antialergjike. Të ketë të shënuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Ngjyra sipas kërkeses se autoritetit kontraktor	Sipas kërkeses se autoritetit kontraktor	
Dyshek neonati	Cope	Dysheku të jetë i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbërja nga brënda me dy shtresa vatine të fortë, ku nga njëra anë të ketë porozitet për qarkullimin e ajrit, dhe i veshur nga jashtë me mbulesë të fortë të padepërtueshme, injifugo (kundër zjarrit), antibakteriale dhe antialergjike. Të ketë të shënuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Ngjyra sipas kërkeses se autoritetit kontraktor	Sipas kërkeses se autoritetit kontraktor	
Jastëk	Copë	Mbushje uniforme me fibra sintetike, ngjyrë e bardhë, te kete te shenuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	40x80 cm	Fibra Sintetike
Jorgan me vatine	Copë	Me mbushje me vatine , me tegela ndarese ne forme kuadrati , veshja e jashteme material pambuku, ngjyre sipas kërkeses se autoritetit kontraktor	190x140	Fibra Sintetike
Jorgan me vatine pediatrik	cope	Me mbushje me vatine , me tegela ndarese ne forme kuadrati , veshja e jashteme material pambuku, ngjyre sipas kërkeses se autoritetit kontraktor	150x100 cm (per moshat 5-14 vjec) dhe 100x100 cm per moshat 0-5 vjec)	Fibra Sintetike
Këllëf dysheku	Copë	Material nga njera ane pambuk dhe nga ana tjeter e papershkueshme nga uji me qepje me llastik per te futur dyshekun , te kete te shenuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Logo DSHSSr-se.. me emërtesën sipas kërkesës së autoritetit kontraktor,	210x110	100 % pambuk + material I papershkues hem nga uji

Dokumentat standarde të tenderit

Këllëf dysheku pediatrik	cope	Material nga njera ane pambuk dhe nga ana tjetër e papershkueshme nga uji me qepje me llastik për të futur dyshekun , të ketë të shënuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Logo DSHSSr-se.. me emërtesën sipas kërkesës së autoritetit kontraktor	155x75	100 % pambuk + material I papershkues hem nga uji
Çarçafe shtrati	Copë	160-180gr/m ² , Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Të jete shënuar Logoja e Spitalit të DSHSSr-se me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, si dhe data e futjes të materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	260x160 cm	100 % pambuk
Çarçafe shtrati pediatrik	Copë	160-180gr/m ² ., Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Logoja e Spitalit të DSHSSr-se me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	220x140 cm	100 % pambuk
Carcaf neonati		Të jete material 100% pambuk ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor të jete shënuar Logoja e Spitalit të DSHSSr-se me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor,si dhe data e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	120*120	100% pambuk
Carcaf Zarf	cope	Dy fletesh ,me qepje nga të katër anët care në fund për të mundësuar futjen e jorganit Të jete material 100% pambuk Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Të ketë të shënuar Logon e DSHSSr-se me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor,si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	220 x 160 cm	100 % pambuk
Carcaf zarf pediatrik	cope	Dy fletesh ,me qepje nga të katër anët care në fund për të mundësuar futjen e jorganit .Të jete material 100% pambuk .Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Të ketë të shënuar Logon e DSHSSr-se me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor,si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor	180x110cm (për moshat 5-14 vjec) dhe 130x110 cm (për moshat 0-5 vjec)	100% pambuk

Dokumentat standarde të tenderit

Kellef jasteku	cope	Mbulese dyshe,ku nga njera ane ka nje te care si xhep,per te lejuar futjen e jastekut Ngjyre e bardhe 160-180 gr/m ² me logon e DSHSSr-se si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	50x80 cm	100% pambuk,
Peshqire pacienti	cope	Material pambuku, ngjyre e bardhe me logon e DSHSSr-se si si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	90x50	100% pambuk,
Pizhama Pacienti (burra/grash)	Copë	Pizhama komplet (bluze +pantallona) , material i plote njëngjyrëshe pesha 350 gr/m ² , pantallonat me llastik xhaketa me jake kemishe ose jake V, me mëngë të gjata të gjëra, masat (XS, S,M, L, XL, XXL) me kopsa perpara dhe dy xhepa. Specifikat e me sipërme - sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Me logon e Spitalit te DSHSSr-se si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	Gjatesia sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	Materiali i 75% pambuk dhe 25 % polyester.lah et ne temperature 60°
Kemisha grash	cope	Te jete material I plote,masat (XS,S,M,L,XL,XXL) Specifikat e me sipërme - sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Me logon e Spitalit te DSHSSr-se si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor	Gjatesia sipas kerkeses se autoritetit kontraktor	Materiali i 75% pambuk dhe 25 % polyester.lah et ne temperature 60°
Robdisham	cope	Material pambuk me lidhje anash ose mbrapa njëngjyrëshe me mende te gjata te gjëra ,masat (XS,S,M,L,XL,XXL) sipas kerkeses se autoritetit kontraktor Me logon e Spitalit te DSHSSr-se si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	Gjatesia sipas kerkeses se autoritetit kontraktor	100% pambuk.
Kompresa kirurgjie /obstetrike	Cope	Te jete material pambuk e qepur metegel ne te 4 anet ,peshe 180-220 gr/m ² , ngjyre sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. Me logon e Spitalit te DSHSSr-se si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor	75 x 90 cm	100% pambuk,
Pandofla Pacienti	pale	Pandofla për përdorim spitalor, material plastik, me gome poroze me ngjyra te ndryshme, e mbyllur nga përpara dhe me vrima për ajrosje, e pajisur me një shtresë ortopedike për të lehtësuar qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë. Materiali të jetë antirreshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji.Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	Numrat e pandoflave sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	Materiali të jetë plastic, antirreshkitës , rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtuesh

Dokumentat standarde të tenderit

				ëm nga uji
Batanije	cope	Te jete 60% lesh dhe 40 % akrilik,me permasa 200x160 cm,ngjyre bezhe ose blu Ngjyra sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. Te kete te shenuar Logon e DSHSSr-se me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor,si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	200x160	Te jete 60% lesh dhe 40 % akrilik,me permasa 200x160
Batanije pediatrike	cope	Te jete 60% lesh dhe 40 % akrilik Ngjyra sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. Te kete te shenuar Logon e DSHSSr-se me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor,si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor	150x100	Te jete 60% lesh dhe 40 % akrilik,me permasa 160x160
Batanije neonati		Te jete material 60% lesh dhe 40% akrilik,permasa 150x90 cm, Ngjyra sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. Te kete te shenuar Logon e DSHSSr-se me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor,si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor	125x100	Te jete material 60% lesh dhe 40% akrilik
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALIT TË BUTË TË EKIPIT TË SALLAVE OPERATORE DHE TË SALLAVE OPERATORE				
Emërtimi	Njësia	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji i materialit
Kostume ekipi salle jo sterile Bluzë dhe Pantallona	Copë	Bluzë dhe Pantallona:	Gjatësia e bluzës dhe gjerësia sipas kerkeses se autoritetit kontraktor; Gjatësia pantallonit sipas kërkesës së	Përbërje 100% pambuk,
		Bluzë me jakë në formë V me mëngë të shkurtra të gjëra, me xhep lart majtas ku në palën e xhepit të shënohet pozicioni I personelit dhe logo e DSHSSr-se. Nga brenda bluzës të shënohet iniciali i emrit dhe mbiemri i plotë i personelit		
		Pantallona unisex, me llastikë në pjesën e belit, me ose pa xhepa në pjesën e përparme. Masat (S, M, L, XL) sipas kërkesës së autoritetit		

Dokumentat standarde të tenderit

		kontraktor.	autoritetit kontraktor.	
		Densiteti i thurjes 160- 180 gr.		
		Ngjyrë jeshile e errët ose blu e erret sipas kërkeses se autoritetit kontraktor.		
Peshqir salle		Material pambuku, ngjyre e bardhe me logon e DSHSSr-se si si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	90x50	100% pambuk,

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **Specifikimet teknike të Menaxhimit të Procesit të Lavanderisë**

Operatori ekonomik do të ofrojë shërbimin e tij, nga procesi i lavanderisë deri tek kompletimi me inventarin e materialit të butë të shtratit të pacientit.

Sipërmarrësi është i detyruar të disponojë të gjitha kapacitetet larëse dhe dezinfektuese, tharëse, hekurosëse dhe paketuëse. Përveç kësaj, sipërmarrësi duhet të sigurojë për zëvendësimin e materialit të butë, nëse është i dëmtuar apo i amortizuar (sipas kohës së tyre të amortizimit dhe sipas nevojës).

Sipërmarrësi siguron inventarin e materialit të butë të nevojshëm, për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratit që ka Spitali Sarandë, me emërtimin/sigllën përkatëse të institucionit kontraktues (DSHSSr), datën e futjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Inventari i materialit të butë, në kuptimin e kësaj kontrate, emërtimi, përmasat, dimensionet, cilësia dhe normat e përdorimit në kohë, do të përfshihen në specifikimet përkatëse.

Sipërmarrësi do të lajë, dezinfektojë, thajë, paketojë, të transportojë dhe shpërndajë deri në pavion bazën e materialit të butë, si dhe të bëjë shërbimin e plotë deri tek shtrati i pacientit.

Rregullat e shtrimit të shtratit do të bëhen, sipas protokolleve të kujdesit infermieror, manualit të kujdesit spitalor, rregullave të higjienës me njoftimin e hapjes së kartelës së re të shtrimit nga K/infermjeri/a e shërbimit, si dhe sa herë të nevojitet nga shërbimi.

Larja dhe dezinfektimi, në repartin e lavanderisë do të bëhet në mënyrë të përqëndruar, duke respektuar të gjitha procedurat dhe protokollat e higjienës, nga marrja në dorëzim e materialit të butë të papastër të ndarë sipas nëndarjeve dhe zonave të rrezikshmërisë (thasët me ngjyrë), tek dorëzimi i materialit të butë, të larë, të hekurosur dhe të pakëtuar sipas këtyre protokolleve, deri në shtrimin e shtratit të pacientit sipas protokolleve infermiore. Pjesë e këtij procesi është edhe sigurimi i pastrimit të plotë kimik – mekanik, në temperaturat e duhura, dhe i procesit të hekurosjes.

Larja e inventarit të materialit të butë, do të bëhet sipas frekuencave të percaktuara në tabelat e mëposhtme dhe sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Dokumentat standarde të tenderit

r N	INVENTARI	Kellef dysheku	Jastek	Kellefe Jasteku	Carcafe Shtrati	Kompresa	Jorgan me Vatine (per periudhen qe	Carcafi zarf (per periudhen qe	Peshqire	Pizhama	Pandofla pacienti	Kemisha grash	Batanije (per periudhen qe do	Robdishan
		Fre k/ditore	Fre k/ditore	Fre k/ditore	Fre k/ditore	Fre k/ditore	Fre k/ditore	Fre k/ditore	Fre k/ditore	Fre k/ditore	Fre k/ditore	Fre k/ditore	Fre k/ditore	Fre k/ditore
1	Patologjia	2 here ne jave	1- here ne mu aj	3 here ne jave	3 here ne jave	0	4- here ne vit	2 - here ne jave	2 - here ne jave	2 - here ne jave	1 - here ne vit	2 - here ne jave	3 here ne vit	2 here ne jave
2	Infektivi	2 here ne jave	1- here ne mu aj	3 here ne jave	3 here ne jave	0	4- here ne vit	2 - here ne jave	2 - here ne jave	2 - here ne jave	1 - here ne vit	2 - here ne jave	3 here ne vit	2 here ne jave
3	Pediatria	2 here ne jave	1- here ne mu aj	3 here ne jave	3 here ne jave	0	4- here ne vit	2 - here ne jave	2 - here ne jave	2 - here ne jave	1 - here ne vit	2 - here ne jave	3 here ne vit	2 here ne jave
4	Kirurgjia	2 here ne jave	1- here ne mu aj	3 here ne jave	3 here ne jave	1 here ne dite cdo operacion	4- here ne vit	2 - here ne jave	2 - here ne jave	2 - here ne jave	1 - here ne vit	2 - here ne jave	3 here ne vit	2 here ne jave
5	Matemiteti	2 here ne jave	1- here ne mu aj	3 here ne jave	3 here ne jave	1 here ne dite cdo operacion	4- here ne vit	2 - here ne jave	2 - here ne jave	2 - here ne jave	1 - here ne vit	2 - here ne jave	3 here ne vit	2 here ne jave
6	Pranim Urgjencia	2 here ne jave	1- here ne mu aj	3 here ne jave	3 here ne jave	0	4- here ne vit	2 - here ne jave	2 - here ne jave	2 - here ne jave	1 - here ne vit	2 - here ne jave	12 here ne vit	2 here ne jave
7	Poliklinika	0	0	0	1- here ne dite	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Dokumentat standarde të tenderit

8	Sherbimi miekut roie	2 her e ne jave	1- here ne mu aj	1- here ne dite	1- here ne dite	0	4- here ne vit	1- here ne dite	1- her e ne dite	1 - here ne dite	0	0	3 here ne vit	0
---	-------------------------	--------------------------	------------------------------	--------------------------	--------------------------	---	-------------------------	--------------------------	---------------------------	---------------------------	---	---	------------------------	---

Nr rend	SALLAT E OPERACIONIT	Frekuence
1	Kostumet e ekipit te salles	1 here ne dite/per cdo operacion

Nr	MATERIAL TE BUTA PERSONEL MJEKSOR, NDIHMES DHE SANITAR	FREKUENCA
1	Perparese mjeku	1 here ne jave
2	Kostume infermieri /sanitare	1 here ne jave
3	Peshqire	2 here ne jave
4	Pandofla personeli	1-here ne vit

Tërheqja dhe dorëzimi i inventarit të materialit të butë në pavione, do të bëhet me grafik të hartuar nga Drejtoria e Spitalit . Grafiku është i detyruar të zbatohet nga të dyja palët, dhe në rastet e ndryshimit të tij, miratimi duhet të bëhet me nënshkrim po nga të dyja palët.

Përdorimi i inventarit të materialit të butë brënda pavionit, bëhet dhe mbetet nën përgjegjësinë e personelit të sipërmarrësit të kontrolluar nga autoriteti kontraktor, sipas procedurave të mëposhtme:

Etapat e këtij procesi cdo ditë:

Çdo ditë K/infermierja e pavionit ose personi i autorizuar prej saj, përpilon, siglon dhe dorëzon, kërkesën (Fletë-forcën e Pavionit) për ditën e nesërme për material të butë, duke cilësuar numrin shtrimeve të reja, të cilën e dorëzon brënda orës 12:00 tek AK (Komisioni i mbikqyrjes dhe manaxhimit te sherbimit te lavanterise dhe hotelerise të Spitalit Sarande – Grupi i punes)

Grupi i punes të Spitalit, në bazë të kërkesave ditore (fletëve të forcave të pavionit) harton pasqyren ditore përmbledhëse ne total per gjithë Spitalin, dhe ia dorëzon sipërmarrësit brënda orës 13:00 për ditën pasardhëse.

Peshimi dhe numërimi i materialit të butë të larë, të thatë, të hekurosur, si dhe të paketuar do të bëhet çdo ditë në ambjentet që do caktohen nga Autoriteti Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës, çdo ditë në orën 08:00 nën prezencën e përfaqësuesit të operatorit te kontraktuar dhe komisionit te ngritur nga AK (Grupi i Punes), duke mbajtur proces-verbalin përkatës të firmosur nga palët. Ky dokument do ketë vlerë financiare, pasi likuidimi i operatorit ekonomikë do të bëhet mbi bazën e proces verbaleve të nënshkruara nga palët për çdo ditë.

Vetëm pasi të jetë peshuar dhe numëruar, materiali i butë, është gati për tu shpërndarë nga OE në shërbimet përkatëse, sipas kërkesave të shërbimit të bërë një ditë më parë. Materiali i bute i palare do dale me cope dhe do hyje i lare me kg.

Shpërndarja e materialit të butë në pavione, do të bëhet nga OE, çdo ditë pas orës 7:00 deri në orën 15.00, sipas grafikut të përpiluar nga Grupi i Punes dhe miratuar nga palët.

Mbas peshimit dhe numerimit të materialit të butë OE ia dorezon kryeinfermierit të pavionit dhe në momentin e dorëzimit do të mbahet proces verbal në (Kg) dhe do të firmoset nga përfaqësuesi i OE dhe kryeinfermieri i pavionit përkatës.

Kryeinfermieri i pavionit dhe Grupi i Punes bën kontrollimin për larjen, hekurosjen, cilësinë e materialit të butë dhe në rast konstatimi të materialit të butë defektos ose të papastër, e kthen mbrapsht duke e pasqyruar në proces-verbal. Ky proces-verbal duhet të ketë të saktësuar numrin e materialit të butë të marrë në dorëzim nga Kryeinfermieri/a i/e pavionit.

K/infermieri/a e pavionit ose personi i autorizuar prej saj, do të evidentojnë dhe konfirmojnë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me shërbimin që kryhet, cilësinë dhe sasinë e kërkuar, si dhe për çdo parregullsi do të konfirmojnë dhe informojnë me shkrim në Grupi i Punes.

Tërheqja e materialeve të buta të papaster nga pavioni, do të bëhet nga OE deri në orën 15.00, duke iu referuar Rregullores në parandalimin e infeksioneve spitalore.

Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës, prej ditës së hënës deri ditën e dielë, (operatori ekonomik duhet të sigurojë edhe materialin e butë për mbulimin e nevojave në pavion, dhe shtrimin e shtratit të pacientit, gjatë fundjavës) gjatë 8 orëve, ndërsa për Shërbimet e Urgjencës e Reanimacionit do të jete 24-orësh , edhe sipas kërkesës së Kryeinfermierit të pavionit në rast të ndryshimit të materialit të butë bëhet i domosdoshëm për pacientë të veçantë.

Per nevoja për material të butë shtesë, pas miratimit të kërkesës së shefit të shërbimit nga i Grupi i Punes, OE do të procedojë me dorëzimin e materialit të butë shtesë, të kërkuar nga shërbimi.

Në raste të konstatimit të mungesave dhe/ose dëmtimit të materialit të butë për periudhën e lënë nën administrim e personelit të Spitalit , do të mbahet një procesverbal, të firmosur nga të dyja palët, një kopje e të cilit do të dorëzohet në Grupi i Punes dhe OE do të bëjë menjëherë zëvendësimet përkatëse.

Riparimi i materialit të butë të dëmtuar, bëhet nga OE duke ruajtur përmasat, dimensionet, përbërjen fillestare (të gjitha specifikimet teknike të materialit të butë).

OE detyrohet të zëvendësojë materialin e butë të vjetëruar në përdorim me material të butë të ri sipas jetëgjatësisë së çdo materiali të butë dhe sipas nevojës.

Në të gjitha rastet kur OE dhe/ose autoriteti kontraktor konstatojnë material të butë të dëmtuar, të dy palët mbajnë një proces verbal dhe më pas procedohet me nxjerrjen nga përdorimi të këtij materiali të butë duke bere asgjësimin e tij .

Për raste të gjendjes së jashtëzakonshme, epidemive apo pandemive, lavanderia do të funksionojë sipas kushteve që do të vendose Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë.

Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë në prani të përfaqësuesit të OE, dhe të përpilojë akt kontrole, për të evidentuar çdo parregullsi në lidhje me kryerjen e shërbimit.

I gjithë materiali i butë në përdorim, me përfundimin e kontratës, i dorëzohet Spitalit të Sarandë pa kundërpaguesë.

Të gjitha kostot për ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë në Spitalin e Sarandës do të sigurohen nga vetë OE.

Marrëdhëniet financiare midis palëve, do të përcaktohen në momentin e lidhjes së kontratës.

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandës likujdon çdo muaj OE, bazuar në sasinë e materialit të butë të paster të thatë në kilogram sipas proces verbaleve të peshimit dhe përmbledhëses mujore të forcës së pavionit, të hartuar nga Grupi i Punes dhe të miratuar nga të dyja palët. Grupi i

Dokumentat standarde të tenderit

Punes, harton përmbledhësen mujore, duke u bazuar në kopjet e procesverbalit të dorëzimit të materialit të butë në pavione çdo ditë.

Kur OE nuk bën ndërrimet e materialit të butë të shtratit të pacientit sipas afateve të përcaktuara, me ankesën me shkrim të shërbimit/pavionit, përfaqësuesi i Spitalit përpilon informacionin përkatës duke i bashkëngjitur një proces – verbal, në bazë të të cilit vërtetohet se nuk është kryer shërbimi. Për çdo ditë, shtrati që nuk është ndërruar në afat, sipërmarrësi i mbahet vlefte e llogaritur e materialit të butë të thatë që nuk është ndërruar. Në rastet kur mungesa e shërbimit përsëritet, OE i paguan gjobë Spitalit , sa dhjetëfishi i vlerës së shërbimit të munguar të llogaritur në shërbim.

Proces – verbalet për ndalesat dhe gjobat, i mbahen sipërmarrësit në pagesën mujore të radhës. Ato mund të kundërshtohen nga OE në Drejtorinë e Spitalit të Sarandes brenda muajit (30 ditë) vijues. Jashtë këtij afati, këto procese do të quhen të pranuar nga palët.

Personeli që punësohet nga OE në shërbimin e lavanderisë, brenda territorit të Spitalit, është i detyruar të zbatojë protokollet e kujdesit të higjienës, të kujdesit infermieror, si dhe rregulloren e Spitalit. Në rastet kur kjo shkelet, punonjësi përkatës largohet nga puna nga OE me kërkesën me shkrim të Drejtorisë së Spitalit, informacionit dhe proces verbalit përkatës.

Kushtet që duhet te plotesoje operatori ekonomik:

Fuqia punëtore që kërkohe nga autoriteti kontraktor;

Nr	Personeli	Nr.punonjësve
1	Pergjegjes sherbimi	1
2	Punetore ne lavanderi	6
3	Punonjese sherbimi	10
4	Punetore ngarkim shkarkimi	2
5	Shoferi	2
	TOTALI	21

Për punonjesit e mesiperm, operatori ekonomik duhet paraqesë

Kontrata pune të vlefshme në të cilat të jetë i përcaktuar pozicioni i punës dhe afati saj.

Librezat shëndetësore ku të vërtetohet se nuk janë mbartës të sëmundjeve infektive sipas nenit 17 të ligjit 15/2016 “Për parandalimin e luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive “.

Një nga stafi i punonjësve të ketë certifikatë trajnimi për mirëmbajtjen e pajisjeve industriale /elektroteknike lëshuar nga një ent publik ose privat që ushtron aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Dokumenti i lëshuar nga entet private të jetë e shoqëruar me certifikatë akreditimi lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Shoferat të jenë të pajisur me leje drejtimi.

Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë makineri për larje, tharje, hekurosje, paketimi, transporti dhe karroca shërbimi deri tek shtrati i pacientit, me kapacitet larjeje minimumi 193.46 kg në ditë, të vërtetuara me dokumenta (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi dhe/ose kontrate qeraje për cdo makineri të vërtetuara me dokumenta (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi që të vërtetojë pronësinë e qeradhënësit të cilat të paraqesin kodin perkates te makinerise).

Viti i prodhimit të ketyre makinerive të jete i dhjete-vjecarit të fundit.

Dokumentat standarde të tenderit

OE ofertues duhet të shoqërojë me fotot dhe skedat teknike profesionale ku të përcaktohet qartë funksioni, kapaciteti, viti i prodhimit për llojet e makinerive të vendosura në ambjentet e lavanderisë të listuara si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia minimale e kërkuar
1	Linjë larje-tharje industriale me pompë detergjente automatike me kapacitet larje minimum 193.46 kg/ditë . Linja larje – tharje do të përbëhet nga pjesët e mëposhtme: a - Transportuesi automatik i teshave të palara në dhomën e larjes, b - Dhoma e larjes, c - Dhoma e procesit të shtrydhjes, d -Transportuesi automatik i teshave të shtrydhura drejt dhomës së tharjes, e - Dhoma tharjes së teshave. f - Pompa automatike të marrjes së peshuar të detergjentëve.	Cope	1
2	Makineri Hekurosëse (Rul) Profesionale	Cope	2
3	Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash	Cope	2
4	Karroca metalike shumekateshe per materialin e bute	Cope	8
5	Peshore elektronike me kapacitet jo me pak se 100 kg e cila duhet të jetë e kalibruar dhe të shoqëruar me akt kolaudimi nga autoritete përkatëse (Drejtoria e përgjithshme e Metrologjisë)	Cope	1
6	Makineri me sistem dozimi elektronik automatic të detergjenteve që përdoren gjatë procesit të larjes dhe dizinfektimit të karrocave te jete me permasa te pershtatshme per karrocac e kerkuara.	Cope	1

Këto makineri duhet të jenë të instaluar në ambjentet e lavanterisë të cilat do të verifikohen nga KVO , pas hapjes së ofertave përsa i përket të gjitha llojeve të makinerive dhe funksionimit të tyre gjatë procesit të larjes të dëshmuara në një proces pune që do të monitorohet nga KVO. Ky verifikim do të kryhet pas dorezimit të ofertave si kusht i detyrueshëm kualifikimi.

Nuk do të pranohen fatura tatimore për blerje pajisje lavanterie, të cilat janë lëshuar pas datës së shpalljes së procedurës.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MAKINERIVE

Kontrata ka një vlerë ekonomike dhe një rëndësi të veçantë për buxhetet spitalore dhe si e tillë OE duhet të krijojë besueshmeri për AK si dhe të sigurojë zbatimin e LIGJIT Nr. 15/2016 PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E INFEKSIONEVE DHE SËMUNDJEVE INFEKTIVE.

Linja e kërkuar me pjesët perberese, duhet të realizojë një proces larje/tharje ku të gjitha miniproceset të kënaqen kohën e tyre të programuar si dhe detergjentet e peshuar automatikisht, e cila jep besueshmerinë e një kontrate të një institucioni ku niveli i ndotjes në reparte të veçanta edhe në situatën pandemike detyrojnë AK të kerkojë mjete profesionale.

Linje larje-tharje industriale me pompe detergjente automatike me kapacitet larje minimum jo me pak se 193.46 kg/dite e perbere nga disa procese kerkohet te jete e 10 vjecarit te fundit dhe profesionale duke gene se spitalet kane tesha te nivelit te larte te ndotjes.

Ne argumentimin e fondit eshte percaktuar nje sasi ditore e parashikueshme prej 193.46 kg e cila ne situaten e pandemise mund te kete rritje dhe ndotje me te madhe. AK kerkon besueshmeri qe nje linje e tille te jete e 10 vjecarit te fundit per faktin e avancimit teknologjik si dhe shkalles se amortizimit te pajisjeve e cila lidhet drejteperdrejte me efikasitetin dhe cilesine e larjes.

AK u detyrua pikerisht nga amortizmi dhe perdorimi pajisjeve manual, te kerkonte kete sherbim me operator ekonomik sepse procesi i larjes kryhet, por dezinfektimi ishte proces i cenuar duke mos realizuar cilesisht sherbimin ne cilesine dhe sigurine higjenike ne nivelin e kerkuar .

Kerkimi i linjes se tille te larjes/tharjes profesionale nga AK, siguron besueshmerine qe sasia e rrobave me sasine rreth 193.46 kg e lare njeheresh ne te njejtin proces kohor dhe jo i copezuar eshte ne te njejtin cilesi si ne larje edhe tharje. Automatizimi qe permban ne vetevete linja shmang hedhjen manuale te rrobave te ndotura nga burimi njerezor nga koshat e palara drejt makinerise si dhe te marrjes automatike te rrobave te lara drejt tharjes.

Ky proces i automatizuar shmang hedhjen e rrobave pjese -pjese nga punonjesit duke i ekspozuar ata vete perpara infektimit si dhe ndotjes me te madhe te ambientit me rroba te palara sidomos per situaten e pandemise e cila ka ndryshuar masat mbrojtese ne te gjitha nivelet.

Niveli i ndotjes se repartit te infektiv kerkon nje proces larje ku detergjenti, dezinfektanti etj. te kene karakteristike ne skeden e tyre te permbajtjes kunder virusit, bakterit edhe vete larja kimikotermale. Nje proces i tille sigurohet shume me shpejt, me kohe te menaxhueshme edhe kur ka rritje te sasise ditore (pandemie, ose gripi ne dimer) dhe mbi te gjitha me cilesi kur ka automatizim te procesit duke kerkuar marrjen automatike te dezinfektantit, duke shmangur ne kete menyre perdorimin e sasive jokorrekte te tij, te kerkuar manualisht duke humbur besimin qe larja mund te kryehet por jo dezinfectimi i tyre.

Reparti i maternitetit ka sasi te madhe teshash me ndotje gjaku ku sot ne spitale nje nga burimet e transmetimit te covid eshte edhe ndotja e tyre me gjak dhe mosedezinfektimi cilesor i tyre duke humbur ph pas larjes, kusht qe kerkon detyrimisht AK te krijoje besueshmeri ne cilesine sidomos te dezinfektimit .

Procesi kimiko termal arrihet vetem kur ka detergjente cilesor me karakteristika te densitetit, viskozitetit, ph, alkalinitetit edhe te peshuar korrekt, ne te kunderten eshte i cenuar si proces. Automatizimi pikerisht arrin me cilesisht edhe me besueshmerisht procesin e dizinfektimit dhe te larjes.

Rruli i hekurosjes si mjet qe realizon nje proces pune qe edhe ai ne vetevete perben nje dezinfektim, kerkohet te jete i viteve te fundit pikerisht per te ruajt cilesine edhe te krijoje besueshmerine qe mjetet per nje kontrate te tille specifike spitalore te jene ne gjendje jo te amortizuar

Pikerisht edhe kerkimi i nje personi te stafit i trajnuar ne fushen e elektroteknikes perben nje garanci qe keto mjete jane ne mirembajtje te vazhdueshme edhe qe nuk e cenojne sherbimin e kerkuar nga AK.Mirembajtja e vazhdueshme eshte nje kusht qe tregon seriozitetin e vazhdimesise se punes edhe ruan cilesine e pajisjeve per realizimin e kontrates. Kalibrimet e pompave automatike duhet te jene pjese periodike e procesit e cila kerkon detyrimisht nje staf te trajnuar per ta realizuar.

Dokumentat standarde të tenderit

Karrocat qe mbartin edhe transportojne rrobat e ndotura duhet te jene te dezinfektuara sepse si mjet mund te behen burime te perhapjes se semundshmerise dhe kontaminimit. Dezinfektimi i tyre automatik eshte nje proces po aq i rendesishem sa i teshave persa i perket perhapjes se infeksionit.

Kjo linje do te shmange edhe numrin e larte te kerkimit te punonjesve te lavanterise si dhe te kerkimit te testimit te dezinfektimit te teshave nga nje laborator i certifikuar ne cdo furnizim si mase mbrojtese kunder covid-19 edhe semundjeve te tjera infektive.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: SHERBIMI I LAVANTERISE DHE HOTELERISE

Dokumentat standarde të tenderit

Nr	Përshkrimi I Shërbimeve	Njesia	Sasia e pritshme
1	Shërbimin e Lavanterisë dhe Hotelerisë	kg	193.46 kg/dite

Afatet e ekzekutimit: 48 muaj nga lidhja e kontratës

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Kryerja e Shërbimit të Lavanderisë dhe Hotelerisë në Spitalin Sarandë i cili është një institucion shëndetësor i cili ofron shërbim spitalor për një periudhë -48 muaj

Detyrat: **Kryerja e shërbimit sipas kërkesave të specifikimeve teknike (shtojca nr.9)**

Materiali I bute që do të blihet ,do të lahet dhe zëvendësohet sipas jetëgjatësisë së materialit (përberjes së tij) dhe kushteve të autoritetit kontraktor;do të jete

Dyshek spitalor,kellef dysheku;jastek ;kellef jasteku;carcaf shtrati ,carcaf zarf,jorgan vatine.Pizhame pacienti,kemisha grash Robdishan grash ,Pandofla pacienti dhe personeli ,carcaf neonati,batanije,batanije neonati,kompresa,kostume të ekipit të sallës ,peshqir personeli/pacienti/sallë,perparese mjeku , kostume infermieri /sanitare/personel ndihmes

Disa nga rregullat baze për qarkullimin e materialit të bute në pavionet e Spitalit Sarandë, për parandalimin dhe eliminimin e infeksioneve spitalore.

Rregullat për eliminimin e infeksioneve spitalore, mbështeten në manualët e kujdesit spitalor, në manualët e parandalimit të infeksionit nozokomial, në rregullat e higjenes, në ligjin e inspektoriatit sanitar shtetëror, në protokollin e kujdesjeve infermierore si dhe në praktikën me të mira të spitaleve të bashkimit evropian, në shërbimin dhe kujdesin spitalor.

Shpërndarja:

-Personeli i sipërmarrës, që kryen proceset për ndërrimin/shtrimin e shtratit të pacientit ashtu dhe të terheqjes së materialeve të ndotura, duhet të ketë veshje identifikuese, të njohur nga autoriteti kontraktor. Ai duhet të zbatojë protokollin e kujdesit infermieror në ndërrimin dhe shtrimin e shtratit të pacientit, si dhe rregullat e higjenes.

-Ndarja e materialeve bëhet mbas çdo ndërrimi të shtratit, gjatë procesit të larjes apo kujdesit ndaj pacientit.

-Materiali i bute duhet të manipulohet me dorëza josterile një përdorimshme, ai nuk duhet transportuar duke e mbajtur në dorë nga personeli apo lenë në tokë.

-Mbledhja e materialeve të papastrës, do të bëhet në një vend të shërbimit, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në thasë identifikues me ngjyrë dhe sigelë perkatese të llojit të materialit të ndotur, të cilët do të qëndrojnë aty deri në momentin e dorëzimit.

-Thasët e rrobave mbushen deri në 2/3, mbyllet krejtësisht dhe vendosen në dhomën apo vendin e parashikuar në shërbim për depozitimin e materialeve. Terheqja nga OE duhet të bëhet sa më shpejt të jete e mundur.

-Thasët nuk duhet të terhiqen mbi dysheme.

- Karroca e materialeve, sherben per mbajtjen e thaseve me ngjyra, per depozitim e materialeve te ndotura nga nje shtrat ne tjetrin. Karroca eshte e pajisur me rrota dhe e ndare me thaset specifike me ngjyre me siglen perkatese identifikuese.
- Karroca e materialeve, nuk futet ne dhomen e pacientit. Ne momentin e nderrimit te pacientit, duhet te largohet cdo objekt duke bere kujdes per aparatet dentare, auditiv, stilolaps apo material tjeter preres.
- Larja cdo dite karrocat e mbajtjes se thaseve te materialit te ndotur, moslarja asnjehere e materialeve ne sherbim, si dhe mos marrja asnjehere e materialit per t'a lare ne shtepi.
- Sipermarresi terheq nga pavioni inventarin e mbyllur me thaset me ngjyra te percaktuara sipas zonave dhe normave higjieno-sanitare, per larje dezinfektim nga personi i autorizuar klinika-k/infermieri/ja, dhe ne te njejten kohe dorezon ne pavion inventarin e paster te hekurosur dhe te paketuar.
- Inventari qe merret ose dorezohet, eshte gjithmone i palosur dhe i paketuar.
- Mbledhja e materialit te ndotur kryehet nga punetori i sherbimit te lavanderise cdo mengjes.
- Shperndarja e materialit te paster per hospitalizim dhe veshjet e punes, behet ne cdo sherbim nga personeli i autorizuar nga sipermarresi.
- Ne asnje rast materialet nuk hidhen nga sherbimet.

Thaset e thurur

Thaset e thurur ,me ngjyra e poshteshenuara dhe me siglen perkatese , vendosen ne nje mbajtes me rrota (karroce) dhe administrohen nga sipermarresi .

Thaset e verdhe “material I kontaminuar “ vendosen carcafet ,kellefet,pizham-kemishat e te semureve .

Qese plastike Blu - “material I kontaminuar “ , nga nje pacient pas ekzaminimit ne mjeksine nukleare .

Qese plastike Jeshile-“ material I kontaminuar “,me rrezik mikrobiologjik,

Thase gri –veshje e personelit shendetsor dhe ndihmes (sanitarre ,barrelista etj)

Thase vishnje – mbulesa ,mbrojtese dysheku , bluza pambuku,

Thase blu – material I piset

Vendi i kryerjes së shërbimeve: **Spitali Sarande**

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR²

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

² Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumentat standarde të tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Dokumentat standarde të tenderit

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

